



Data: 01.03.2017

Ref.: 122/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010); neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr. 762/16 e datës 06.12.2016 e Kolegjit "Dardania", si e pa bazuar.

II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.1249/16, datë 07.11.2016.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Dardania" ka parashtruar kërkesë (nr. 762/16 e datës 06.12.2016) për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (nr.1249/16, datë 07.11.2016). Përmes kësaj kërkesë, Kolegji Dardania ka kërkuar të rishqyrtohet vendimi për mos riakreditim të programit të studimit Juridik, LLB (240 ECTS), nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC).

KSHC ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit "Dardania" dhe ka vendosur të refuzojë kërkesën për rishqyrtim të datës 06.12.2016 dhe të jetë në fuqi vendimin e KSHC-së të datës 07.11.2016.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka analizuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të dorëzuar nga Kolegji "Dardania" në lidhje me mos akreditimin e programit Juridik, LLB (240 ECTS). KSHC ka konstatuar se ky institucion nuk ka sjellë ndonjë dëshmi e cila do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të Kolegjit Dardania është trajtuar me saktësi nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit dhe se argumentet për mos akreditimin e programeve të studimit janë ofruar në Raportin Final të Ekspertëve të pranuar më datë 25 Tetor 2016.

Sa i përket konstatimit tuaj në pikën 11.8 (faqe 11) të kërkesës tuaj (nr. 762/16 e datës 05.12.2016) se udhëzimi për këshillën juridike i dhënë në vendim e KSHC (nr.1249/16, datë 07.11.2016) është i gabuar sepse ju kemi referuar ligjit nr.02/L-28, dhe jo ligjit të ri (Nr. 05/L -031) të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ky konstatim është plotësisht i gabuar sepse sipas nenit 162 të ligjit Nr. 05/L -031, ky ligj hyn në fuqi një vit pas shpalljes në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, derisa ky ligj është shpallur me dekret Nr. DL-014-2016, datë 13.06.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Vendimi i Këshillit Shtetëror i Cilësisë (KSHC) i Agjencisë së Kosovës për Akreditim është marrë në përputhje të plotë me nenin 15, pika 8 e Ligjit mbi Arsimin e Lartë nr.04/L-037, datë 29 gusht 2011, dhe neni 22, pika 2 e Udhëzimit Administrativ 20/2016, datë 20.09.2016.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.


Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi lu dërgohet:

- Kolegjit "Dardania";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë





Prishtinë, më 21.11.2016

KËRKESË PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT

ANKUES:

Kolegji Dardania, i themeluar në vitin 2004 si Institucion i Arsimit të Lartë, i licensuar nga MASHT-i – Certifikata Nr. 898/02-1 të datës 01.12.2004, dhe Vendimi Nr. 583/02-1 të datës 09.05.2007 dhe i riakredituar në nivel institucional prej pesë (5) viteve (01. Tetor 2013- 30. Shtator 2018 (shih për këtë edhe Vendimet e AKA-së Nr. 493/13, datë 08.07.2013 dhe 551/14, datë 04.07.2014).

OBJEKTI:

Kërkohe ndryshimi i Vendimit nr. 1249/16, datë 07.11.2016 të KSHC së AKA-së me objekt "Refuzimin e riakreditimit të programit Bachelor në Drejtësi" të Kolegjit Dardania dhe miratimi i kërkesës për akreditim sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

BAZA LIGJORE:

Nenet 1, 2, 3, 4, 8, 11, 12, 13, 14 dhe 15 ligjit nr. 04/L-037 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës".

Nenet 9, 10, 11 dhe 29 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së RSK Nr.02/2013 "Mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës".

Nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 44, 46-48, 52, 53, 55, 88, 89, 92, 95, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130 dhe 131 të ligjit nr. 05/L-031 "Për procedurën e përgjithshme administrative".

Nenet 3, 21, 22, 24, 32, 47, 53 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës Kosovës.

Nenet 6 dhe 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe protokollit shtesë i kësaj Konvente nr. 12.

PËRPARA:

KËSHILLIT SHTETËTOR TË CILËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KËRKESË PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT

- ANKUES:** Kolegji Dardania, i themeluar në vitin 2004 si Institucion i Arsimit të Lartë, i licensuar nga MASHT-i – Çertifikata Nr. 898/02-1 të datës 01.12.2004, dhe Vendimi Nr. 583/02-1 të datës 09.05.2007 dhe i riakredituar në nivel institucional prej pesë (5) viteve (01. Tetor 2013- 30. Shtator 2018 (shih për këtë edhe Vendimet e AKA-së Nr. 493/13, datë 08.07.2013 dhe 551/14, datë 04.07. 2014).
- OBJEKTI:** Kërkohej ndryshimi i Vendimit nr. 1249/16, datë 07.11.2016 të KSHC së AKA-së me objekt "Refuzimin e riakreditimit të programit Bachelor në Drejtësi" të Kolegjit Dardania dhe miratimi i kërkesës për akreditim sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 1, 2, 3, 4, 8, 11, 12, 13, 14 dhe 15 ligjit nr. 04/L-037 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës".
- Nenet 9, 10, 11 dhe 29 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së RSK Nr.02/2013 "Mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës".
- Nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 44, 46-48, 52, 53, 55, 88, 89, 92, 95, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130 dhe 131 të ligjit nr. 05/L -031 "Për procedurën e përgjithshme administrative".
- Nenet 3, 21, 22, 24, 32, 47, 53 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës Kosovës.
- Nenet 6 dhe 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe protokollit shtesë i kësaj Konvente nr. 12.
- PËRPARA:** KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

*I nderuar z. Kryetar,
Të nderuar të tjerë anëtarë,*

Kolegji Dardania, i lincencuar si Institution i Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka paraqitur kërkesën për akreditimin e disa programeve të studimit ku midis të tjerash përfshihej edhe kërkesa për riakreditimin e programit të studimit Bachelor në Drejtësi ose Juridik. Kolegji Dardania ka hartuar Raportin e Vetëvlersimit i cili i është dorëzuar Agjencionit Kosovar të Akreditimit, sipas kërkesës së zyrtarëve të saj. Më tej, ne jemi njoftuar për caktimin e ekspertëve të jashtëm dhe për zhvillimin e vizitës së tyre pranë institucionit tonë gjatë datave 10 dhe 17 Tetor 2016. Gjatë zhvillimit të vizitës institucioni ynë ka ofruar bashkëpunim të plotë dhe ka mundur çdo lloj informacioni të kërkuar dhe që është vlerësuar me rëndësi për vlerësimin e kërkesës tonë. Pas hartimit të projekt-raportit të vlerësimit, nga ana jonë janë vërejtur gabime, pasaktësi dhe vlerësime jo objektive të dukshme në pjesën e vlerësimit të programit Bachelor në Juridik. Kështu, në përputhje me procedurat dhe brenda afateve ligjore kemi paraqitur vërejtjet dhe komentet tona në lidhje me këtë projekt. Nga shqyrtimi i raportit përfundimtar kemi vërejtur që në kundërshtim me provat, faktet dhe legjislacionin në fuqi, eksperti përkatës i ngarkuar me vlerësimin e këtij programi, nuk ka reflektuar dhe nuk ka marrë në konsideratë shumicën e kundërshtimeve dhe komenteve tona ndonëse ato kanë qenë të drejtë dhe të bazuara në standardet ligjore të detyrueshme në Republikën e Kosovës. Bazuar në këtë raport, Këshilli Shtetëror i Cilësisë i AKA-së, ka vendosur mos aprovimin e kërkesës së Kolegjit Dardania "Për riakreditimin e programit të studimit Bachelor në Juridik". Në gjykimin tonë, si institucion i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, gjykojmë që ky vendim nuk është i bazuar në prova, fakte dhe në ligj dhe për këtë arsye brenda afatit ligjor paraqesin këtë ankim duke ju parashtruar ndër të tjera arsyet si vijojnë:

1. Nga ana e ekspertëve dhe nga ana e vetë Këshillit është injoruar tërësisht fakti që kërkesa jonë nuk ka pasur si objekt akreditimin, por riakreditimin e këtij programi. Në këtë kuadër, vizita e kryer dhe përfundimet e ekspertit kanë mbuluar edhe çështje të cilat vlerësimi i mëparshëm i datës 26-27 Maj 2013 dhe i vetë Këshillit ka qenë pozitiv dhe ka vlerësuar dhënien e akreditimit. Po ashtu, vërehet se eksperti ka pasur mendim të ndryshëm sidomos përsa i përket strukturës së kurrikulës ose të planit të studimeve të cilat nuk janë konstatuar dhe mbështetur nga vlerësimi i ekspertit të mëparshëm. Në këtë kuadër, kjo mënyrë vlerësimi ka shkelur "Parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme" të

mishëruar në nenin 8 të ligjit nr. 05/L-031 "Për procedurën e përgjithshme administrative". Ky parim nënkupton që për institucionin tonë, çështjet e vlerësuar pozitivisht nga raporti i mëparshëm nga i njëjti ekspert (shih Raportin e ekspertëve të datës 26-27.Maj 2013 me të cilin është akredituar programi bachelor i Juridikut) priteshin të ishin të prezumuara si pozitive dhe si rregull nuk duhej t'ju nënshtroheshin rivlerësimit në këtë proces vlerësimi, por vetëm një rivefikim të ekzistencës së tyre. Duke vepruar në këtë mënyrë, nga ana juaj është lejuar si shkelja e këtij parimi ashtu edhe shkelja e parimit kushtetues të sigurisë juridike, pasi konkretisht për këto çështje, ishte marrë më parë nga institucionet kompetente një vendim pozitiv. Kjo nënkupton, që kurrikula e një programi studimi nuk mund të ndryshojë sa herë që riakreditohet ky program apo sa herë që ndryshojnë ekspertët vlerësues të këtij programi. Kjo gjë bie ndesh edhe me nenin 13 të ligjit nr. 04/L-037 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës" pasi cënon në thelb të drejtën e autonomisë së institucionit tonë për të vlerësuar në përputhje me kërkesat ligjore të legjislacionit në fuqi në RKS, strukturën e një programi studimi dhe kësajsoj edhe të fizionomisë së tij dalluese në raport me institucionet e tjera në vend.

2. Eksperti ka vlerësuar tërësisht gabim dhe nuk ka marrë parasysh asnjë nga vërejtjet dhe komentet tona në lidhje me strukturën e kurrikulës e cila ndonëse nuk duhet të ishte objekt vlerësimi në përputhje me argumentin e parashtruar në pikën 1 të kësaj kërkesë, përsëri duhet të ishte objektiv dhe profesional dhe jo sikurse ka argumentuar ai. Konkretisht, nga ana e tij është konstatuar se në semestrin e parë dhe të dytë 40 kreditë janë përdorur për lëndë të përgjithshme joligjore dhe vetëm 18 kreditë për lëndë që klasifikohen si hyrje në parimet e së drejtës të përgjithshme. Ky konstatim është tërësisht jo i saktë dhe jo profesional, pasi iu referuar strukturës së programit mësimor për këto dy semestra dhe për çdo semestër, ne kemi vetëm katër kurse të cilat nuk janë në lëndë qartësisht juridike dhe ky numër përfshin edhe lëndët "Gjuhë angleze" dhe "Shkrimin Akademik" lëndë këto të cilat llogariten për 24 ECTS. Përveç kësaj, këto dy lëndë janë një domosdoshmëri për një kurrikulë të ditëve tona dhe në të njëjtën kohë kërkesë e vetë ekspertëve dhe procesit të akreditimit. Duhet sqaruar që në listën e lëndëve të listuara si hyrje në parimet e përgjithshme të drejtës eksperti ka përfshirë edhe lëndët si: Teoria dhe Bazat e së Drejtës, Historia e Shtetit dhe Ligjit, lëndë të cilat sipas përfundimeve të tij duhet të hiqen për të adresuar çështjen e krediteve. Sigurisht ky përfundim është krejtësisht i gabuar dhe jo profesional dhe nuk merr parasysh as standardet ndërkombëtare në lidhje me pasjen e këtyre lëndëve në këtë kurrikulë. E para, pavarësisht nga emri, është e njëjta lëndë që në vendet fqinje quhet "E Drejtë Publike", në Itali njihet si

"Diritto Pubblico" (E Drejtë Publike) në Universitetin e Prishtinës si "Fillet e së Drejtës", në Sloveni haset si "Juriprudencë" apo në Angli si "Introduction to Law" ose (Hyrje në të Drejtë). Megjithatë, në rastin e Kosovës dhe të RSH e atë të Italisë, kjo lëndë është lënda bazë më juridike me të cilën hasen studentët dhe krijon bazat për kalimin në të Drejtën Kushtetuese, të Drejtën Administrative, të Drejtën Civile etj. Prandaj, përfshirja e tyre në semestrin e parë është një domosdoshmëri për një program të përgjithshëm juridik. Për më tepër, kjo kurrikul është hartuar në një skemë me 8 semestra dhe jo në një skemë me 6 semestra e cila kërkohet një qasje më radikale për të ngushtuar numrin e lëndëve të ligjit ose lëndëve me karakter Hyrës të Parimeve të Përgjithshëm të së Drejtës. Po ashtu, duke pasur parasysh edhe domosdoshmërinë e mësimit të gjuhës Angleze dhe të njohjes me metodat e kërkimit dhe shkrimit akademik, është tërësisht e pamundur ndryshimi i kësaj strukture. Prandaj, vlerësimi, por edhe veprimet matematikore të ekspertit për këtë çështje janë tërësisht të gabuara dhe nuk duhet të merren parasysh. Po ashtu, parashikimi i lëndës Procedura Civile në semestrin e 7 dhe atë të së Drejtës Civile në semestrin e 4, është vlerësuar si jo i përshtatshëm. Në fakt, eksperti thjesht nuk ka pasur parasysh se procedura civile nuk lidhet vetëm me procedurën në kuadër të mosmarrëveshjeve që burojnë nga e Drejta Civile, por përfshinë edhe procedurat kontestimore të tjera sikurse janë mosmarrëveshjet administrative, mosmarrëveshjet familjare, mosmarrëveshjet tregtare, mosmarrëveshjet midis personave juridikë jofitimprurës, vërtetimin gjyqësor të faktit juridik, procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, detyrimet dhe kontratat, etj. Kësisoj, kjo lënda "Procedura civile" sipas të gjitha modeleve duhet të pasojë të gjithë këto lëndë dhe nuk është e mundur që të bëhet fill pas lëndës "E Drejta Civile". Pra vlerësimi i ekspertit bëhet pa pasur parasysh përmbajtjen e lëndës dhe tregon se nuk ka të qartë se çfarë tematikash duhet të përmbajë kjo lëndë. Po ashtu, edhe sikur të pranohet i mirëqenë, përsëri shkëputja kohore me 2 semestra nuk përbën një tregues ose standard që meriton të theksohet në një raport vlerësimi, pasi nuk ka asnjë tregues botëror që të vërtetojë këtë përfundim. Prandaj, ky përfundim nuk duhet të merret parasysh.

Qëndron fakti se, me qëllim krijimi të identitetit vetanak të programit Kolegji Dardania, siç është konstatuar dhe vlerësuar pozitivisht edhe nga ekipi i ekspertëve, nga katër module specializimi në semestrin e tetë (të cilat ishin të akredituara) është përcaktuar për dy module specializimi.

Në vijim duhet cekur se Kolegji Dardania ka pasur parasysh rekomandimin nga akreditimi i vitit 2013 (shih Raportin e ekipit të ekspertëve të datës 26-27. Maj 2013, fq. 25), i cili për Juridikun kërkonte: "Të zhvillohet identiteti vetanak i programit, të mendohet riardarja e kurseve dhe specializimeve

obligative dhe zgjedhore". Kolegji Dardania ka reflektuar në këtë drejtim duke e freskuar kurrikulën edhe me nëntë (9) lëndë zgjedhore të reja dhe atë:

- në semestrin e III. Sociologjia urbane,
- në semestrin e IV. Hyrje në informatikë, Stereotipet dhe rolet gjinore,
- në semestrin e V. Integrimet evropiane, Psikologjia e delikuencës, Terrorizmi ndërkombëtar – metodat e parandalimit,
- në semestrin e VI. Aftësitë komunikuese, Marrëdhëniet me publikun, dhe
- në semestrin e VII. Diversiteti kulturor dhe fetar.

Kur të kihet parasysh kjo që u tha më lartë, del se nuk qëndron konstatimi i ekspertit, i cili pasi shprehet pozitivisht për reduktim të moduleve në dy specializime thotë "asnjë ndryshim ose zhvillim tjetër nuk ka ndodhur"!

3. Në lidhje me sistemet e vlerësimit brenda lëndëve, ne do të dëshironim për të sqaruar edhe njëherë se skema e paraqitur në vetvlerësim apo në syllabuse të caktuara, është vetëm një skemë e përgjithësuar e cila nuk është e detyrueshme për profesorët e lëndëve përkatëse. Profesorët mund dhe rregullojnë sistemin e tyre të vlerësimit në programin mësimor të tyre ose gjatë zbatimit të tij gjatë vitit akademik përkatës. Në të vërtetë, shumica e stafit tonë zbaton sisteme të ndryshme të vlerësimit që parashikojnë vlera të ndryshme për secilin komponent të vlerësimit jo vetëm nga pikëpamja e një klase në tërësi, por përshtatur edhe për secilin student në bazë të performancës dhe angazhimeve të tij. Në anën tjetër, disa anëtarë të stafit bëjnë vlerësime bazuar edhe në sitemin e "Vlerësimit me kurbë". Kështu, ne e njohin rëndësinë e një sistemi të vlerësimit dinamik në kuadër të lëndëve dhe kemi vullnet për të vazhduar përmirësimin e tij. Ky përfundim dhe sqarim nuk është marrë parasysh nga eksperti.
4. Kolegji Dardania është shumë i ndjeshëm ndaj përfaqësimit gjinor dhe ka bërë përpjekje të mëdha për të nxitur rekrutimin e stafit akademik të gjinisë femrore. Mirëpo, përkundër angazhimit dhe përpjekjeve tona, numri i personelit akademik femra në dispozicion dhe që zotërojnë një diplomë PhD ose të paktën që ndjekin studimet e doktoratës në fushën e jurisprudencës është pothuajse inekzistent. Kjo është arsyeja pse ne kemi një boshllëk të tillë në përfaqësimin gjinor dhe kjo nuk ka qenë kurrë një çështje e parave ose vullneti për të bërë shpenzime shtesë. Megjithatë, ne jemi të angazhuar për të rritur numrin e stafit akademik femra dhe ne mirëpresim rritjen e të diplomuarve PhD femra në

Kosovë në përgjithësi dhe në jashtë vendit. Ky përfundim dhe sqarim nuk është marrë parasysh nga eksperti.

5. Në lidhje me natyrën e përgjithshme të deklaratës së misionit të programit, ne kemi ritheksuar dhe ritheksojmë që deklarata e misionit të programit, bënë pjesë në Deklaratën e Përgjithshme të Misionit të Kolegjit Dardania. Kështu, ne shohim deklaratën e misionit të programit si plotësuese të Deklaratës së Misionit të Kolegjit Dardania. Eksperti ka theksuar që konstatohet një dështim i përfaqësuesve të programit për të siguruar lidhje të forta me strategjinë, por kjo nuk do të thotë se nuk ka lidhje me strategjinë dhe se kjo e fundit nuk është zbatuar plotësisht. Ndërkohë, hendeuku midis përgjegjësve të programit dhe të programit është rezultat i rekrutimit të stafit të ri pas gjetjes dhe rekomandimit të raportit të ekspertëve të akreditimit të mëparshëm. Pra përveçse kjo gjë nuk qëndron, duhet të vlerësohet si një përmbushje e një kërkesë të mëparshme, pasi Kolegji Dardania nëpërmjet investimeve të shumta financiare ka angazhuar staf që plotëson kriteret ligjore të cilët kanë të drejtë të kenë kohën e nevojshme për t'u njohur me dokumentet strategjike të institucionit dhe ky do të jetë një proces dhe qëllim i vazhdueshëm, por kurrësi nuk mund të ketë peshë në vendimin për refuzimin e kërkesës dhe eksperti duhet të kishte marrë parasysh këto komente dhe vërejtje të drejta.
6. Prof. Asoc. Dr. Jordan DACI, është cilësuar në raport se ka qenë një folës zyrtar për programin "Bachelor në Juridik". Në fakt, nuk ka qenë përgjegjës për këtë program, por për programin e "Administrimit public" dhe nuk disponon vetëm gradën Shkencore "PhD", por edhe titullin Akademik "Profesor i Asociuar".
7. Në konkluzionet e ekspertit është thënë se "Kolegji Dardania" nuk e njej rëndësinë e diferencimit institucional dhe identitetit të tij. Nga ky këndvështrim, si rregull i përgjithshëm detyrues, secili staf akademik duhet të shqyrtojë dhe të bëjë përditësimin e sillabusit për çdo vit akademik natyrisht para fillimit të tij. Kjo gjë, zakonisht përfshin rishikimin e tematikës përkatëse të ligjëratave në përputhje me zhvillimet më të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare, rishikimin e literaturës dhe aspekte të tjera të mbuluara nga programi mësimor. Programet mësimore të lëndëve, siç paraqiten në raportin e vlerësimit janë vetëm një model i tij të cilët janë objekte të ndryshimit çdo vit akademik. Si pjesë e diferencimit tonë institucional midis të tjerash, ne mund të themi që kemi një fokus të veçantë në të Drejtën e Bashkimit Evropian dhe aspektet e tjera të integritimit në BE, aspekte këto të nënvizura edhe në raportin e vetvlerësimit. Ndërsa lëndët e tjera, janë: E Drejta e konsumatorit, lëndë të ndryshme të

përqëndruara në aspektet ligjore të ekonomisë dhe një seri lëndës të përqëndruara në fusha të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare, që paraqesin posaçërisht rëndësi në Kosovë, etj. Këto fakte dhe përfundime nuk janë marrë parasysh nga eksperti.

8. Raporti ynë mbulon të gjitha çështjet e kërkuara, siç parashikohet në udhëzimet tona kombëtare. Ne kemi dhënë gjithashtu edhe informacione të përgjithshme për metodat e mësimdhënies, etj, ose mbi konceptin tonë të didaktikës mësimore dhe pas projekt raportit kemi mundësuar informacion shtesë mbi këtë çështje duke theksuar posaçërisht si vijon: "Në formatin e raporti dhe në asnjë rubrikë nuk është kërkuar shprehimisht dhënia e informacioneve mbi konceptin tonë të didaktikës mësimore. Megjithatë, stafi ynë zbaton një gamë të gjerë dhe bashkëkohor të metodave didaktike, si p.sh.: mësimdhënie interaktive, organizimin e gjyqeve imituese (për këtë edhe kemi ndërtuar sallën e posaçme si një Sallë Gjykatë), prezantime, dhënien e detyrave individuale ose në grup, shkrimin e punimeve të ndryshme, përdorimin e materialeve audio dhe video, studimin e rasteve praktike ose casus-ve, etj. Në veçanërisht kërkojmë dhe nxisim stafin që të realizojë, shpërndarjen elektronike dhe të shtypura të materialeve të leximit për çdo lëndë përkatëse, studimin e rasteve praktike dhe forcimin e njohurive praktike etj. Megjithatë, çdo personel është i lirë të zgjedhë metodologjinë e tij didaktike duke pasur parasysh edhe komponentët tonë më të rëndësishëm.
9. Vetë Raporti i vlerësimit është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të zbatueshme në RKS. Eksperti ka parashtruar në raport vlerësime në lidhje me mungesën e informacionit që mundëson detaje krahasuese midis Kolegjit Dardania dhe institucioneve të tjera të krahasueshme. Ne i kemi mundësuar informacion shtesë duke i ritheksuar se "raporti ynë është hartuar si një raport mbështetës për riakreditim të programit dhe jo për një akreditim fillestar. Në këtë mënyrë, ne kemi supozuar faktin se disa nga temat në fjalë janë shteruar në raportin e mëparshëm dhe kemi vlerësuar se nuk ka qenë e nevojshme të përfshihen edhe në këtë raport. Megjithatë, përputhshmëria e programeve tonë mishërohet në aspektet si vijojnë: 1. Përmbajtja e kurrikulës dhe shpërndarja e lëndëve në semestra është e krahasueshme me institucionet e përmendura. 2. Kërkesat për fitimin e diplomës përkatëse, janë të njëjta me ato të institucioneve të tjera vendore pasi këto kërkesa përcaktohen përgjithësisht me ligj. 3. Këto kërkesa janë në përputhje të plotë me procesin e Bolonjës dhe standardet të cilat janë të përbashkët edhe për universitetet e Gracit, Sarajevës, dhe Orebros etj. 4. Klasifikimi i diplomës është gjithashtu i njëjtë me institucionet e përmendur në

veçanti me institucionet vendore. 5. Metodologjitë e aplikueshme të mësimdhënies dhe kërkesave të tjera akademike janë gjithashtu të njëjtë. 6. Cilësia e letaturës që ofrohet për studentët tanë dhe objekteve mësimore dhe ndihmëse është gjithashtu e krahasueshme me këto institucione. Gjithashtu, i kemi kërkuar ekspertit të na tregonte nëse do t'i duhej më shumë informacion i detajuar mbi këtë çështje. Megjithatë, eksperti as nuk ka kërkuar informacion tjetër dhe as nuk ka vlerësuar asnjë nga këto informacione.

10. Kolegji Dardania nuk është pajtuar dhe nuk pajtohet me gjetjen e ekspertit i cili thotë se ekziston përshtypja se shumica e anëtarëve me kohë të plotë vijnë vetëm për ligjëratat e tyre në ambientet e kolegjit. Sigurisht, ky përfundim është krejtësisht subjektiv, paragjykes dhe injoron kuadrin ligjor. Po ashtu, nuk është në detyrën e ekspertit për të ofruar vlerësime të karakterit hamendësues, sepse në këtë rast jo vetëm që nuk lejohet nga ligji, por edhe do të ishte krejtësisht abusive. Përfundimet e ekspertit duhet të mbështeten në fakte. Prandaj, në mungesë të tyre jo vetëm që nuk duhet të merren parasysh, por edhe duhet të refuzohet pranimi i përfundimeve të tyre. Është me rëndësi të theksohet që ekspertët dhe të gjithë pagesat mbulohen nga Kolegji dhe është e pamoralshme, jo etike dhe jo ligjore të shfrytëzohen mjetet e institucionet për të abuzuar me detyrën nga ana e ekspertëve. Agjencioni nuk duhet ta lejojë ndodhjen e këtij fenomeni. Në lidhje me këtë, kemi sqaruar se anëtarët me kohë të plotë shpenzojnë kohën e nevojshme në institucionin tonë në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret tona në fuqi. Marrëdhënia e tyre e punësimit është e përcaktuar mirë dhe e rregulluar në kontratën e tyre përkatëse të punësimit dhe sipas ligjit të punës në fuqi në Kosovë. Ekipi bërthamë të cilin eksperti nuk ka qenë në gjendje ta vërej siç duhet, është në fakt i gjithi i punësuar me kohë të plotë. Prandaj, përfundimet apo supozimet në kundërshtim me faktet dhe ligjin nuk duhet të lejohen të pasqyrohen në raport dhe as nuk duhet të merren parasysh në vendimin e këtij Këshilli të nderuar. Mungesa e një projekti të vetëm të përbashkët të zbatuar nga stafi, nuk është korrekte së pari, pasi institucioni ka organizuar aktivitete të cilat kanë përfshirë thujtë të gjithë stafin. Pra eksperti nuk ka sqaruar se çfarë aktiviteti ka dashur të thotë. Ndërkohë, kërkimi shkencor në tërësi zhvillohet në bazë individuale, por mbështetet dhe nxitet nga Kolegji për të gjithë stafin. Zhvillimi i projekteve kërkimore shkencore në kuadër të institucionit së pari kërkon zhvillimin e qëndrueshëm të institucionit, zhvillim i cili kërkon kohë dhe kjo gjë duhet të merret parasysh, kërkon mbështetjen me financim edhe nga fondet publike, gjë e cila sot në Kosovë, në mënyrë diskriminuese nuk ofrohet për Institucionet Private të Arsimit të Lartë.

11. Eksperti ka theksuar që Prof. Assoc. Dr. Jordan DACI dhe Dr. Blerton Sinani japin respektivisht nga 5 dhe 4 lëndë të detyrueshme. Duke u vlerësuar që kanë një ngarkesë të madhe. Në fakt, ky përfundim është i pavërtetë dhe nuk merr parasysh kërkesat ligjore në RKS, ku sipas pikës 3.2 të Nenit 11 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së RSK "Mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës", përcaktohet që një staf i plotë mund të mbajë deri në 20 orë mësimore në javë. Në rastin konkret, nëse krahasohet ngarkesa në orar dhe shpërndarja e lëndëve në semestra, rezulton që ngarkesa e këtyre profesorëve të jetë shumë më tepër e ulët sesa norma ligjore. Kjo ngarkesë nuk kalon me shumë se 6-8 orë në javë, që është edhe më pak se ngarkesa që mund të kenë këto anëtarë në një institucion tjetër me kohë të pjesshme që është jo më shumë se 10 orë/javë. Po ashtu, e njëjta analizë vlen edhe për anëtarët e tjerë. Ndërkohë, dy anëtarët e stafit të programit juridik Dr.Sc. Hyreme Gurra dhe Dr.Sc. Safet Emrulli sipas ekspertit nuk janë mbartës të ndonjë lënde dhe kështu nuk janë vlerësuar në numrin e përgjithshëm të personelit. Në fakt, këto persona janë punësuar së fundmi dhe për pasojë atyre do t'ju caktohen lëndët sipas kualifikimit të tyre dhe nevojave të institucionit para fillimit të vitit akademik. Konkretisht, në deklaratat e plotësuara nga këta anëtarë për vitin akademik 2016-2017 janë ngarkuar me lëndët (shih deklaratat për angazhimin e stafit akademik). Nga ana e tij eksperti nuk ka kërkuar këtë informacion përpara hartimit të raportit përfundimtar dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim dispononte vetë deklaratat përkatëse. Prandaj, kjo gjë nuk duhet të merrej parasysh në vlerësimin përfundimtar të kërkesës për akreditim. Po ashtu, janë konstatuar dhe më pas ndryshuar disa klasifikime të anëtarëve sikur u përkisnin shkencave sociale dhe jo atyre juridike. Stafit i deklaruar përbëhet nga pesë Prof. Dr. (minus 1 për shkak të moshës) Nga të cilët tre u përkasin shkencave juridike dhe një është i punësuar me kohë të plotë Prof. Dr. Riza Smaka. Po ashtu, ka edhe Prof. Asoc. Dr. Jordan Daci, i cili vazhdon të paraqitet në raport si vetëm Dr.Sc. ndonëse është mundësuar informacioni për tu korrigjuar, ka 4 Doktor të Shkencave nga të cilët 3 janë të shkencave juridike dhe një i shkencave sociale, ka tre Kandidate për PhD nga të cilët 2 janë të shkencave juridike dhe ka dy me magjistraturë. Informacioni që anëtari i stafit Dr.Sc. Rafet Haxhaj është doktor dhe jo kandidat PhD, nuk është pasqyruar ndonëse është dërguar tek ekspertët. Referuar këtyre shifrave, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 11 të Udhëzimit, del që përfundimi i ekspertit është i gabuar, pasi:

- 1). Së pari në asnjë normë juridike në fuqi nuk kërkohet që të gjithë anëtarët duhet të jenë të shkencave juridike përse kohë kjo kërkesë është edhe absurde

duke pasur parasysh që kurrikula e këtij programi përmban edhe lëndë jo juridike që janë të parashikuara.

- 2) Së dyti, numrat janë më tepër sesa kërkojnë standartet pasi konkretisht Udhëzimi kërkon të detyrueshëm vetëm një Prof. Dr., me kohë të plotë dhe ku 50 % e lëndëve duhet të mbulohen nga stafi i brendshëm dhe me gradën Doktor i shkencave. Në këtë rast, janë pikërisht stafi i brendshëm që mbulon së paku 50 % të ngarkesës, pa tejkalluar aspak normat maksimale për javë dhe kemi edhe një numër të madh të anëtarëve të stafit të jashtëm. Kështu, që përfundimi i ekspertit që skuadra aktuale e stafit mund të plotësojë standardet ligjore, por nuk përmbush kriteret e cilësisë për një program juridik bachelor 4 vjeçar, është së pari absurde, së dyti jo ligjore dhe së tretë krejtësisht e pabazuar në fakte. Nëse mund të thuhet që profesorët eminent që janë pjesë e stafit të Dardanisë nuk plotësojnë standardet e cilësisë, kjo do të thotë që asnjë institucion në Kosovë nuk i plotëson.
- 3) Së treti, mos vlerësimi me peshë të njëjtë të stafit që i përket shkencave sociale në raport me peshën e tyre në programin Bachelor në Juridik, jo vetëm që është i pakuptimtë dhe jo ligjor, pasi ligji nuk parashikon dallime në lidhje me këtë çështje, por nuk është as logjikisht e drejtë, pasi programi i studimit smund të shihet i copëzuar, por duhet të shikohet në tërësi.
- 4) Së katërti, nuk është as në tagrin dhe as në moralin e një eksperti që të vlerësojë cilësinë që ofrojnë homologët e tij, qofshin në RKS qofshin edhe në ndonjë vend të botës së tretë. Agjencioni duhet ti udhëzojë ekspertët dhe nuk duhet të lejojë arritjen e përfundimeve të tilla.
- 5) Së pesti, standardet zbatohen pa diskriminim midis institucioneve të tjera në Kosovë. Prandaj, vlerësuar me institucionet e tjera, Kolegji Dardania paraqitet më mirë se ata dhe kësaj, ose duhet t'u hiqet akreditimi edhe atyre ose duhet t'i jepet edhe Dardanisë. Ky është një detyrim kushtetues për Këshillin.
- 6) Së gjashti, raporti student profesor është më i vogël se në çdo institucion tjetër të arsimit të lartë të Kosovës për programet bachelor në Drejtësi. Në këto kushte, nuk e kuptojmë dhe as nuk pranojmë përfundimin e ekspertit.
- 7) Së shtati, përfundimet e ekspertit përveçse janë jo të saktë dhe subjektive, tregojnë edhe një nivel profesional të pamjaftueshëm për të bërë një vlerësim tërësor të një programi. Po ashtu, vërehet qartë edhe një dogmatizim i theksuar i tij në lidhje me disa çështje, qëndrim i cili nuk mund të jetë i

pranueshëm në asnjë vend perendimor, përse kohë po flasim për çështje jo qartësisht dhe përfundimisht të përcaktuara dhe ku relativizmi në vlerësimin e tyre është një standard po aq i pranueshëm sa edhe uniformiteti në vlerësimin e tyre.

- 8) Së teti, Udhëzimi për përdorim të mjetit juridik kundër vendimit të AKA-së në ligjin numër 02/L-28 mbi procedurën administrative është dhënë gabimisht, sepse ligji në fjalë është shfuqizuar me Ligjin numër 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.

Përfundimisht, jemi të bindur që përfundimet e ekspertit janë të pabazuara në prova, fakte dhe në ligj, si dhe nuk ndjekim një logjikë të drejtë as juridike dhe as shkencore, por edhe që janë të bazuara në dogmatizime të papranueshme shkencore. Kësisoj edhe vendimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë nuk rezulton të jetë i bazuar në përfundime të cilat janë të bazuara në prova, fakte dhe në ligj.

PËRSA MË SIPËR

Bazuar në nenet 1, 2, 3, 4, 8, 11, 12, 13, 14 dhe 15 Ligjit nr. 04/L-037 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës", nenet 9, 10, 11 dhe 29 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës "Mbi Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës", nenet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 44, 46-48, 52, 53, 55, 88, 89, 92, 95, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131 dhe 132 të ligjit nr. 05/L-031 "Për procedurën e përgjithshme administrative", nenet 3, 21, 22, 24, 32, 47, 53 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës Kosovës dhe nenet 6 dhe 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe protokollit shtesë i kësaj Konvente nr. 12.

KËRKOJMË:

1. Mundësimin e të drejtës kushtetuese të Kolegjit Dardania për t'u dëgjuar papara se të merret vendim për këtë kërkesë.
2. Përfundimisht, ndryshimin e Vendimit nr. 1249/16, datë 07.11.2016 të KSHC së AKA-së me objekt "Refuzimin e akreditimit të programit Bachelor në Drejtësi" të Kolegjit Dardania dhe miratimin përfundimtar të kërkesës për akreditim sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

KËRKUES
KOLEGJI DARDANIA
PËRFAQËSUAR NGA REKTORJA
PROF. DR. GJYLDANE MULLA


Dokumentacioni i cili është i përmendur më poshtë është në RVV të dorëzuar zyrtarëve të Agjencionit. Gjithashtu, deklaratat e angazhimit:

1. Kopjen e deklaratave për anëtarët e stafit të cilët rezultojnë sipas ekspertit të angazhuar në lëndë.
2. Diplomën e Doktoratës për Anëtarin Dr.Sc. Rafet Haxhaj.
3. Dokumente të tjera mbështetëse.

Me nderime,

Prof. Dr. Gjyldane Mulla

Rektore



Elmi Kelmendi

From: Elmi Kelmendi
Sent: Tuesday, December 20, 2016 10:56 AM
To: 'Blerim Rexha'; lul.raka@uni-pr.edu; 'Mirlinda Batalli'; mirlindabatalli@gmail.com
Cc: Furtuna Mehmeti
Subject: Kërkesat për rishqyrtim e BPrAL Kolegji Dardania
Attachments: KËRKESË PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT - JURIDIK.pdf; KËRKESË PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT - SHKENCA POLITIKE DHE ADMINISTRIM PUBLIKpdf; REQUEST FOR RECONSIDERATION OF THE DECISION - LAW.pdf; REQUEST FOR RECONSIDERATION OF THE DECISION - PSPA -SHPAP.pdf; Skanim - Kërkese per Rishqyrtim te Vendimit Dardania 762-16.pdf; Skanim - Kërkese per Rishqyrtim te Vendimit Dardania 763-16.pdf; Skanim Kërkese per Permiresim te Vendimit Dardania 657-16.pdf

Te nderuar,

Gjeni te bashkangjitur dy kërkesa për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.1249/16, datë 07.11.2016 nga BPrAL Kolegji Dardania të parashtruara me 06.12.2016....

Kërkesa e parë ka të bëjë me mos akreditimin e programit të studimit Juridik LLB, ndërsa kërkesa e dytë i referohet mos akreditimit të specializimit Marrdhënje me publikun në kuadër të programit të studimit Shkenca Politike dhe Administratë Publike...

P.S. Bazuar në Ligjin mbi procedurën administrative ne si AKA kemi afat tridhjetë dit për trajtimin e kësaj kërkesë, rrjedhimisht afati i fundit për përgjigje nga AKA-KSHC në këtë kërkesë është data 06.01.2017.

Me respekt,



Elmi KELMENDI
Senior Legal Officer
Kosovo Accreditation Agency

Address: Student's Center, 2nd floor
10000 Pristina, Kosovo
Tel: +381 38 213576; 20115
Fax: +381 38 213990
E-mail: elmi.kelmendi@rks-gov.net
Website: www.akreditimi-ks.org